

VENDIM
Nr.590, datë 4.9.2019

**PËR KRIJIMIN E BAZËS TË TË DHËNAVE SHETETËRORE TË SISTEMIT
INFORMATIK TË MENAXHIMIT TË NDIHMËS SË HUAJ (SIMNH)**

(Ndryshuar me vendimin nr. 13, datë 13.1.2022)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 7 e 8, të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Menaxhimit të Ndihmës së Huaj (SIMNH).

Sistemi Informatik i Menaxhimit të Ndihmës së Huaj përbëhet nga modulet e mëposhtme:

- a) Moduli i projekteve të partnerëve për zhvillim;
- b) Moduli i investimeve të huaja direkte;
- c) Moduli i PPP-ve dhe koncesioneve;
- ç) Moduli i analitikës;
- d) Moduli i burimit të financimit;
- dh) Moduli i treguesve busan.

3. Sistemi Informatik i Menaxhimit të Ndihmës së Huaj ndërvepron me sistemet qeveritare, si më poshtë vijon:

- a) Sistemin Informatik të Menaxhimit Financiar (SIMF), në administrim të ministrisë përgjegjëse për financat;
- b) Sistemin Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI), në administrim funksional të Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës;
- c) Regjistrin elektronik të koncesioneve/Partneritetit Publik Privat në administrim të Agjencisë për Trajtimin e Koncesioneve.

4. Sistemi Informatik i Menaxhimit të Ndihmës së Huaj përmban të dhëna, të cilat ndahen në të dhëna parësore dhe dytësore, si më poshtë vijon:

4.1 Të dhëna parësore konsiderohen të dhënat e grumbulluara nga vetë SIMNH-ja, që përfshijnë të dhënat mbi projektet, si:

- a) informacion i përgjithshëm i projektit (titulli, kodi identifikues i projektit, objektivi, përshkrimi, statusi i zbatimit, data e fillimit dhe e përfundimit, kohëzgjatja, sektorët e BE-së, sektorët e Organizatës për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (OECD), sektorët e integruar, shënjeshtër tematikë, vendndodhja gjeografike etj.);
- b) organizatat dhe kontaktet (agjencia financuese, agjencia zbatuese, kontaktet e projektit etj.);
- c) informacioni financiar (kostoja e projektit, komponentët, angazhimet, pagesat e planifikuara, pagesat e realizuara etj.);
- ç) monitorimi dhe vlerësimi (lidhja me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) dhe treguesit kryesorë të performancës, treguesit e objektivave të zhvillimit strategjik, treguesit busan etj.);
- d) shënime dhe dokumentacioni bashkëngjitur.

4.2 Të dhëna dytësore përfshijnë informacionin, si më poshtë vijon:

- a) Të dhënat për projektet me financim të huaj, të aprovuara në programin buxhetor afatmesëm;
- b) Të dhënat mbi shpenzimet e projekteve, të cilat mbulohen nga fondet e ndihmës së huaj;
- c) Të dhënat e projekteve me koncesion/Partneritet Publik Privat (PPP);
- ç) Treguesit e SKZHI-së dhe të strategjive sektoriale;
- d) Masat prioritare lidhur me programet zhvillimore dhe projektet kombëtare strategjike;

dh) Referenca me standardet dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

5. Sistemi Informatik i Menaxhimit të Ndihmës së Huaj shkëmben informacion me institucionet publike, sipas parashikimeve të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, lidhur me shërbimet që ofrohen në bazë të legjislacionit përkatës, nëpërmjet platformës qeveritare të ndërveprimit.

6. Bazat e të dhënave shtetërore të institucioneve publike, nga të cilat SIMNH-ja merr të dhëna, janë, si më poshtë vijon:

a) Baza e të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Menaxhimit Financiar (SIMF), që administrohet nga ministria përgjegjëse për financat, e cila ofron të dhënat:

i) për projektet me financim të huaj, të aprovuara në programin buxhetor afatmesëm;

ii) mbi shpenzimet e projekteve, të cilat mbulohen nga fondet e ndihmës së huaj.

b) Baza e të dhënave mbi projektet me koncesion/PPP, që administrohet nga Agjencia e Trajtimit të Konkencioneve (ATRAKO);

c) Baza e të dhënave të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI), në administrim funksional të *Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës* e cila ofron:

i) treguesit e SKZHI-së dhe të strategjive sektoriale;

ii) masat prioritare lidhur me programet zhvillimore dhe projektet kombëtare strategjike;

iii) referenca me standardet dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

7. Përbërësit e arkitekturës software dhe hardware të sistemit miratohen nga autoriteti rregullator koordinues.

8. Subjektet përgjegjëse të SIMNH-së janë, si më poshtë vijon:

a) Institucioni administrues i sistemit SIMNH është *Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës*;

b) *Institucionet, palë të interesuara, janë ministria përgjegjëse për financat, ministria përgjegjëse për Evropën, ministritë e linjës, kryenegociatori për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës dhe institucionet buxhetore të qeverisjes së përgjithshme.*

9. Dhënës të informacionit për bazën e të dhënave të SIMNH-së janë Banka Botërore, Bashkimi Evropian, Republika Federale e Gjermanisë, Suedia, Zvicra dhe partnerët e tjerë për zhvillim dhe integrim, me të cilët është lidhur marrëveshje për shkëmbimin e të dhënave publike për financimet e huaja në Shqipëri.

10. Niveli i aksesit në sistemin dhe bazën e të dhënave të SIMNH-së pasqyrohet, si më poshtë vijon:

a) Administratorët e SIMNH-së kanë të drejtë leximi, shkrimi e modifikimi të të dhënave në sistem si dhe menaxhimi të përdoruesve;

b) Kryeministria dhe ministritë e linjës kanë të drejtë aksesit si lexues informacioni në bazën e të dhënave për projektet me financim të huaj në SIMNH;

c) Publiku ka nivel aksesit si lexues informacioni dhe merr informacion si vizitor i sistemit, në lidhje me një pjesë të të dhënave parësore dhe dytësore;

ç) *Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës* gëzon dhe disponon të drejta të plota administrative mbi SIMNH-në, në rolet:

i) Administrator;

ii) Raportues;

iii) Auditues;

iv) Lexues i informacionit.

d) Struktura përgjegjëse për menaxhimin e sistemit SIMF, në ministrinë përgjegjëse për financat, gëzon të drejtën e lexuesit të informacionit lidhur me pagesat e projekteve të financuara nëpërmjet ndihmës së huaj, të regjistruara në SIMNH;

dh) Banka Botërore dhe partnerët për zhvillim dhe integrim gëzojnë të drejtën e raportuesit të të dhënave për projektet me financim të huaj.

11. Organizimi dhe funksionimi i brendshëm i sistemit dhe bazës të të dhënave të SIMNH-së përcaktohen dhe miratohen me rregullore të brendshme të institucionit administrues, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, “Për bazën e të dhënave shtetërore”.

11/1. Sistemi Informatik i Menaxhimit të Ndihmës së Huaj, për krijimin e informacionit përkatës gjeohapësinor të të dhënave shtetërore të SIMNH-së ndërvepron me Gjeoportalin Kombëtar në administrim të Autoritetit Shtetëror të Informacionit Gjeohapësinor (ASIG), në përputhje me rregullat e legjislacionit në fuqi për informacionin gjeohapësinor.

12. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama